



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

AKT PËRCJELLËS

Për:	Menaxherin e prokurimit "Korporata Energjetike e Kosovës" OE ankues "EURO-ING"SHPK	Kopje:	Paneli Shqyrtues - OSHP Nr.336/19
Prej:	Ekspert shqyrtues i prokurimit Ilaz Papaj		
Lënda:	Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën me Nr.336/19 të parashtruar nga OE "EURO-ING"SHPK me seli ne Prishtinë për aktivitetin e prokurimit "Furnizimi me gjysumfabrikate (disqe) për punimin e dhëmbëzorëve" me nr.prokurimi 19-810-1-2-1 të iniciuar nga AK-"KEK"		
Datë	02.07.2019		

Bazuar në nenin 114 të Ligjit Nr. 04/L-042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, ju njoftojmë me raportin, lidhur me ankesën e dt:24.06.2019 me nr.336/19 të parashtruar nga OE **"EURO-ING"SHPK** lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Furnizimi me gjysumfabrikate (disqe) për punimin e dhëmbëzorëve"** me nr.prokurimi 19-810-1-2-1 të iniciuar nga **AK-"KEK"**

AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur me këtë kërkesë, të veprojë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

Të bashkangjitur gjeni raportin e ekspertit shqyrtues.

Ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues

Raporti i ekspertit shqyrtues për ankesën e parashtruar nga OE **"EURO-ING"SHPK** lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Furnizimi me gjysumfabrikate (disqe) për punimin e dhëmbëzorëve"** me nr.prokurimi 19-810-1-2-1 të iniciuar nga **AK-"KEK"**



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

		25.06.2019	02.07.2019
<i>Nënshkrimi i ekspertit</i>		<i>data e autorizimit të ekspertit.</i>	<i>data e dorëzimit të raportit</i>

N. 105, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit

Me datën 24.06.2019 OE **“EURO-ING”SHPK** me seli ne Prishtinë, ka parashtruar ankesë në OSHP, Kundër Vendimit të Autoritetit Kontraktues të datës 13.06.2019 lidhur me aktivitetin e prokurimit **“Furnizimi me gjysumfabrikate (disqe) për punimin e dhëmbëzorëve”** me nr.prokurimi 19-810-1-2-1 të iniciuar nga AK-**“KEK”**

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

Operatori Ekonomik Ankues “EURO-ING”SHPK me seli Prishtinë

Dispozitat e shkelura sipas OE ankues janë:

- Neni 1 -Qëllimi
- Neni 6 – Ekonomiciteti dhe Efikasiteti.
- Neni 7 – Barazia në Trajtim/Jo Diskriminimi.
- Neni 59 – Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve
- Neni 60-Kriteret për Dhënien e Kontratës

DEKLARATA DETALE MBI FAKTET DHE ARGUMENTET:

Të nderuar,

Autoriteti Kontraktuesna ka dërguar letrën standarde për tenderues të pasuksesshëm me datë 05.06.2019

Raporti i ekspertit shqyrtues për ankesën e parashtruar nga OE **“EURO-ING”SHPK** lidhur me aktivitetin e prokurimit **“Furnizimi me gjysumfabrikate (disqe) për punimin e dhëmbëzorëve”** me nr.prokurimi 19-810-1-2-1 të iniciuar nga AK-**“KEK”**

dhe na ka njoftuar se fitues i këtij tenderi është shpallur OE "B&D Emgineering"

Ne me datë 06.06.2019 kemi pasur qasje në dokumentet e OE të rekomanduar për kontratë ku kemi vërejtur se ky OE është i papërgjegjshëm sepse nuk ka plotësuar Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale të parashikuara në nenin 9.1&9.2 ku është kërkuar "1.Autencitetit produkteve dhe cilësisë reprezentues,ndërsa dëshmi e kërkuar dokumentare është kërkuar "1.Autorizim nga prodhuesi ose dileri i autorizuar (nëse është nga dileri atëhere si dëshmi të sillet kontratë ose autorizim mes dilerit dhe prodhuesit),për shitjen e produkteve që ofroni".

OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar një autorizim të prodhuesit Euro Sider,kurse autorizimi është i dhënë nga kompania Metal Element.Pra si diler në këtë rast është Metal element por që në dosje nuk ka të bashkangjitur as kontratë e as autorizim ndërmjet liderit dhe dilerit ashtu siç është kërkuar në dosje të tenderit dhe për këtë arsye ky OE është i papërgjegjshëm.

Gjithashtu OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm ehe për faktin se nuk i ka plotësuar kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale të parashikuara në nenin 9.1&9.2 ku është kërkuar 3.Certifikatë të produkteve në lidhje me përshtatjen dhe specifikat ose standardet,ndërsa dëshmi dokumentare është kërkuar "3.Certifikata (Certifikimi i prodhuesit sipas ISO 9001 2015).Ky operator ekonomik e ka ofruar ISO certifikatën që është vetëm në prerje të metalit të karbonit,ndërsa nuk e ka për prodhimin e materialeve sic është kërkuar në FDT.

OE i rekomanduar për kontratë poashtu nuk ka ofruar specifikim për secilin artikull,ndërsa në FDT është kërkuar "2.Dokuemntacioni autentik i prodhuesit katalogë e prodhuesit të produkteve të bashkangjitur përshkrimit teknik detale për artikujt që ofertoni nga prodhuesi.nëse produktet janë në katalog sipas specifikimeve teknike të kërkuara të nenvizohen pozicionet e kërkuar".

Në katalog nuk janë produktet dhe për një pjesë shumë të madhe nuk janë përshkrimet teknike detale,ndërsa Neni 39 i rregullave dhe Udhëzuesi operativ për Prokurim Publik (RRUOPP) e parasheh shume qarte:

. Është dorëzuar katalogu por mungon Specifikacioni teknik për mallrat e ofruara—refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtutjeshëm.

Në vendimin e dt.14.06.2019 të AK për refuzim të kërkesës për rishqyrtim,autoriteti kontraktues është munduar të arsyetoj vendimin e tyre paraprak,në dy pika sa i përkejt katalogut dhe autorizimit,ndërsa nuk është marrë fare me pretendimin e tretë i cili ka të bëjë me Iso certifikatën.

Përfundimisht ekzaminimi,vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë konform nenit 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët,sipas nenit 60 të LPP-së dhe poashtu jemi diskriminuar në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së.

Pra autoriteti kontraktues nuk ka pasur parasysh nenin 60 paragrafin 1.1 të LPP-së,e që kjo dispozitë parasheh njërin ndër kriteret kryesore për dhënie të kontratës- tenderi i përgjegjshëm me çmim më të

ulët, e i cili kriter ka qenë i përcaktuar edhe nga ana e autoritetit kontraktues si kriter kryesor i dhënies së kontratës, mirëpo AK-ja nuk e ka rekomanduar për kontratë OE të përgjegjshëm, por ka rekomanduar OE i cili nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP që të merr:

VENDIM

APROVOHET, ankesa e "EURO-ING" si e bazuar,

ANULOHET, njoftimi dhe vendimi i AK-së për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në **RIVLERËSIM** dhe gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofretave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në insitucionet tjera kompetente.

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit për kontratë:	04.03.2019
Lloji i procedurës së aplikuar:	Procedurë e hapur
Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar:	Kontratë publike -Furnizim
Vlera e parashikuar e kontratës:	75,000.00 €
Kriteri për dhënie të kontratës(N.52)	tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët
Afati i fundit për dorëzimin e ofertave	27.03.2019
Data e hapjes së ofertave	27.03.2019
Data e përfundimit të vlerësimit të ofertave	15.05.2019
Data e njoftimit me letrën standarde për tenderues të eliminuar apo të pa suksesshëm	05.06.2019
Data e njoftimit për pezullimin e aktivitetit të prokurimit	30.05.2019
Data e kërkesës për rishqyrtim	10.06.2019
Data e vendimit të AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim	11.06.2019

Kriteret për vlerësim:

Çmimi më i lirë

III.2) KUSHTET PËR PJESËMARRJE

III.2.1 Kërkesat e përshtatshmërisë

Kërkesa 1: Operatori ekonomik duhet të përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë të Ligjit Nr. 04 L-042 Neni 65.

Kërkesa 2: Një vërtetim i nënshkruar nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit.- kërkohe vetëm për fituesin e tenderit.

Kërkesa 3: Një dokument lëshuar nga Gjykata kompetente që vërteton se operatori ekonomik i përmbush "Kërkesat e përshtatshmerisë" Pika III.1.1.) 2.a,c,d dhe e. – original ose kopje e noterizuar .- kërkohe vetëm për fituesin e tenderit.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Evidenca 1. Një deklaratë nën Betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën e përcaktuar ne dosjen e tenderit. Dëshmitë lidhur me kërkesat e pranueshmërisë

Evidenca 2 dhe 3 do të kërkohe nga tenderuesi të cilit autoriteti kontraktues ka ndër mend që t'ia jap kontratën. Këto dokumente duhet të dorëzohen nga tenderuesi para dhënies së kontratës. Në rast të dështimit të dorëzimit të këtij dokumenti, tenderi në fjalë do të refuzohet

III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:

Kërkesa 1: Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit

Kërkesa 2: Regjistrimi i TVSH; ne vendin e themelimit

Kërkesa 3: Regjistrimi i numrit fiskal

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1: Një dokument i lëshuar nga autoriteti përkatës publik në vendin e themelimit të operatorit ekonomik me të cilin evidentohet regjistrimi i operatorit ekonomik në atë vend Kopja e certifikatës së biznesit)

2: Kopja e certifikatës TVSH-se

3: Kopja e certifikatës numrit fiskal

III.2.3) Kapaciteti teknik dhe profesional:

Kërkesa 1: Autenticiteti i produkteve dhe cilësisë reprezentues

Kërkesa 2: Mostrave të produktit, përshkrimeve, prezantimeve i vizatime të produkteve që duhet të furnizohen

Kërkesa 3: Certifikatë të produkteve në lidhje me përshtatjen dhe specifikat ose standardet

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1: Autorizim nga prodhuesi ose dileri i autorizuar (nëse autorizimi është nga dileri atëherë si dëshmi të sillet kontratë ose autorizim mes dilerit dhe prodhuesit), për shitjen e produkteve që ofroni

2. Dokumentacioni autentik i prodhuesit katalogë e prodhuesit të produkteve të , bashkangjitur përshkrimit teknike detale për artikujt që ofertoni nga prodhuesi . Nëse produktet janë në katalogë sipas specifikimeve teknike të kërkuara të nënvizohen pozicionet e kërkuar.

3. Certifikata (Certifikimi i prodhuesit sipas ISO 9001 2015)

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike:

Nr.	Operatorët Ekonomik	Vendi	Çmimi	Vërejtje
1.	N.P.T "HEKURANI"	Ferizaj	63,720.00	Jo
2.	"EURO-ING" SHPK	Prishtinë	60,180.00	Jo
3.	N.T.P "SNR"	Prishtinë	68,576.88	Jo
4.	N.T.N "B&D ENGINEERING"	Prishtinë	36,285.00	Jo

Komisioni vlerësues pranë AK:

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues.

Autoriteti Kontraktues për vlerësimin e tenderëve ka caktuar komisionin në përbërje, si në vijim:

- Xhevat Krasniqi – Kryesues i komisionit
- Shkelzen Shosholli – Anëtare e komisionit
- Hasan Mexhuani – Anëtar i komisionit

Raporti i komisionit vlerësues:

Komisioni vlerësues gjatë vlerësimit të ofertave si ofertë të përgjegjshme ka vlerësuar te katër ofertat e lartëcekura në tabelle, ndërsa si ofertë të suksesshme ka propozuar ofertën e OE "N.T.N "B&D ENGINEERING"" ne vlerë prej 36,285.40 € (si oferta më e lirë) dhe është propozuar si ofertë fituese.

Përgjigje në pretendimet ankimore të grupit të OE ankues "EURO-ING" SHPK

Përgjigje në Pretendimin 1.

Lidhur me pretendimin e grupit OE "EURO ING" SHPK se AK gjatë vlerësimit të ofertave ka propozuar ofertën e OE N.T.N "B&D ENGINEERING" si ofertë fituese (ofertë me e lirë) edhe pse ky operator duhet të shpallet i papërgjegjshëm sepse nuk ka plotësuar Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale të parashikuara me nein 9.1&9.2 ku është kërkuar "1. Autenciteti i produkteve dhe cilësisë reprezentues, ndërsa si dëshmi e kërkuar dokumentare është kërkuar" 1. Autorizim nga prodhuesi ose dileri i autorizuar (nëse është nga dileri atëherë si dëshmi të sillet kontrata ose autorizim mes dilerit dhe prodhuesit, ekspertit shqyrtues ka këtë mendim.

OE N.T.N”B&D ENGINEERING” i propozuar si fitues i mundshëm i këtij aktiviteti të prokurimit ka dorëzuar një letër Autorizim nga dileri “Metal element” që autorizon OE “B&D Engineering” ta marr pjesë në këtë aktivitet të prokurimit dhe ky diler(Metal Element) në letër Autorizim është partner me prodhuesin “Euro Sider Scalo”por që nuk dëshmohet me kontratë apo autorizim të kërkuar sipas kërkesës së Dosjes së tenderit.

Konsideroj që pretendimi i grupit të OE anukes është **i bazuar**

Përgjigje në Pretendimin 2.

Lidhur me pretendimin e grupit OE “EURO ING”SHPK se AK gjatë vlerësimit të ofertave ka propozuar ofertën e OE N.T.N”B&D ENGINEERING”si ofertë fituese(ofertë me e lirë) është i papërgjegjshëm për faktin se nuk i ka plotësuar kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale të parashikuara me nenin 9.1 dhe 9.2 ku është kërkuar certifikate të produkteve në lidhje me përshtatjen dhe specifikat ose standardet ku si dëshmi është kërkuar Certifikimi i prodhuesit sipas ISO 9001 2015,konsideroj që OE N.T.N”B&D ENGINEERING” i propozuar si fitues i mundshëm ka dorëzuar certifikatën ISO 9001:2015 e cila ka validitet dhe i përmbush kërkesat nga dosja e tenderit

Konsideroj që pretendimi i OE anukes është **i pa bazuar**

Përgjigje në Pretendimin 3.

Lidhur me pretendimin e grupit OE “EURO ING”SHPK se AK gjatë vlerësimit të ofertave ka propozuar ofertën e OE N.T.N”B&D ENGINEERING”si ofertë fituese(ofertë me e lirë) dhe ky OE nuk ka ofruar specifikim për secilin artikull sic është kërkuar në dosjen e tenderit “Dokumentacioni autentik i prodhuesit katalog i prodhuesit të produkteve në dokumentacionin e saj,konsideroj që OE N.T.N”B&D ENGINEERING ka ofruar dokumentacion/dëshmi të mjaftueshme mbi specifikat e artikujve sic është kërkuar në dosjen e tenderit.

Konsideroj se pretendimi është **i pa bazuar**.

Konstatohet se pretendimet ankimore janë pjesërisht të **bazuara**

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Në bazë të sqarimeve të lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të **pranohet pjesërisht** për arsyen që i theksuam në përgjigjeje të pretendimit ankimore të më sipërm. Eksperti shqyrtues në përputhje me nenin 114 pika 2 të LPP-së rekomandon autoritetin kontraktues që ta **RIVLERËSOJ** aktivitetin e prokurimit **“Furnizimi me gjysumfabrikate (disqe) për punimin e dhëmbzorve”** me nr.prokurimi 19-810-1-2-1